European Commission

A do t'i pije ujërat e zeza?

Një broshurë uji për të rinjtë



Environment

Europe Direct është shërbim që ju ndihmon t'u përgjigjeni pyetjeve tuaja mbi Bashkimin Evropian

Numri i telefonit pa pagesë (*):

00 800 6 7 8 9 10 11

(*) Disa operatorë nuk lejojnë thirrjet në numrat 00 800 ose thirrjet e tilla mund të jenë me pagesë.

Më shumë informata mbi Bashkimin Evropian janë në dispozicion në internet (http://europa.eu).

Të dhënat e katalogimit mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra për Publikime e Bashkimit Evropian, 2012

ISBN 978-92-9238-081-6
doi: 10.2871/34931

© Bashkimi Evropian, 2012
Reprodukimi lejohet nëse burimi është i njohur.

Botuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Shtypur në letër të recikluar

A do t'i pije ujërat e zeza?

Një broshurë uji për të rinjtë

Përmbajtja

Uji: burim i kufizuar 4

Uji i pijshëm 6

Uji nga rubineta: vital për shëndetinç 6

Thesar i fshehur 6

Tokë e fortë ose tokë që thith? 6

Çfarë cilësie ka uji në vendin ku jetoni? 8

Si prodhohet uji i rubinetës suaj? 8

Sa ujë përdorim? 10

Respekto ujin: çfarë mund të bësh TI
Këshilla për përdorimin e ujit 12

Ujërat e zeza 14

Ku shkon uji i fëlliqur? 14

Nuk janë të gjitha fekalet ndotës 14

Kemikaljet në ujërat e zeza 14

Trajtimi i ujit në mbarë Evropën 14

Çfarë ndodh në kolektorin e trajtimit? 16

Procesi i pastrimit i përshkruar në detaje 16

Problemi me shiun 17

Mbyllja e qarkut: reciklimi i ujit 18

Ndalesa e ardhshme: lumenjtë dhe deti 18

Çfarë ndodh me trajtimin e ujërave të zeza në vendin ku jetoni? 18

Drejt plazhit! 20

Uji i larjes po bëhet më i pastër 20

Çfarë testohet? 23

Kërko vendin më të favorshëm për t'u larë 23

Plazhet me flamuj të kaltër 23

Mbeturinat ujore 24

Çfarë bën BE-ja 26

Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm 26

Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza 26

Ruajtja e pastërtisë së ujërave për larje 27

Pastrimi i detërave dhe oqeaneve 27

Uji: burim i kufizuar

Imagjino këtë skenë: po bëhesh gati për të shkuar në ndonjë mbrëmje gazmore por kur e lëshon dushin, uji që rrjedh është ngjyrë kafe. Nuk mund të lash flokët me ujë të këtillë! Shkon të marrësh nga lavatriçja xhinset për t'i tharë, por ato duken më të fëlliqura se para larjes. Çfarë të veshësh tani? Miku të thërret për të të treguar se mbrëmja është anuluar, pasi që ai nuk është ndjerë mirë pas larjes në plazh dje. Çfarë bezdie. Të ka ardhur në majë të hundës dhe me disponimin e këtillë shkon në kuzhinë të bësh një kafe. Rubineta lëshon ca pika uji dhe pastaj asgjë. A mund të bëhet më keq se kaq?

Ne varemi nga uji për gjithçka që bëjmë. Ne e konsiderojmë normal faktin që mund të pijmë, të lajmë dhe të notojmë në ujë të pastër dhe të sigurtë kurdoherë që dëshirojmë dhe se uji i fëlliqur i banjove, dusheve dhe lavamanëve tanë do të merret dhe vendoset diku ku nuk do të duhet ta shohim, t'i marrim erë ose të notojmë në të.

Mirëpo, kjo qasje e menjëhershme në ujë të pastër dhe instalime hidrosanitare nuk është e lirë. Uji në çesmat tona duhet të burojë nga më shumë resurse – i filtruar, i pastruar dhe i nxjerrë nga pompat nëpër shtëpitë tona. Duhet të testohet që të sigurohemi se është i sigurtë për t'u pirë. Uji i fëlliqur duhet të merret përmes rrjetit të kanalizimit dhe duhet të trajtohet. Para se të kthehet nëpër lumenj dhe në det uji duhet të pastrohet nga bakteriet që shkaktojnë sëmundje dhe ndotësit e shkaktuar nga njerëzit.

Duhet të kujdesemi për ujin më shumë se kurrë më parë. Fundja, ne ndoshta jetojmë në planet përplot me ujë, mirëpo uji i freskët që na duhet në jetën e përditshme përbën vetëm 2.5% të sasisë së përgjithshme të ujit në planetin Tokë. Pjesa më e madhe e



Rezervoar i ujit: Liqeni Kap-de-Long (Francë)

ujit është e papërdorueshme, në formë të shkëmbinjve të akullit, akullnajave, borës dhe avullit në atmosferë. Në fakt, vetëm 1 % e ujit është i freskët dhe i përdorshëm, shumica e tij është e fshehur në tokë dhe në shtresa të gurëve në tokë. Vetëm një pjesë e vogël del në sipërfaqe, nëpër liqene, lumenj, dhe përrenj.

Uji i freskët dhe i pastër mund të jetë i qasshëm pa vështirësi të mëdha, nëse jetoni në mal, afër ndonjë përroi që nuk është ndotur nga persona të tjerë, nga kafshë ose burime tjera ndotëse.

Shkenca e ujit

Shkenca e lëvizjes, shpërndarjes dhe cilësisë së ujit njihet si 'hidrologji' (nga greqishtja 'hudor': ujë). Kjo është një disciplinë antike e përdorur së paku 6 000 vjet, e cila ka mundësuar që civilizimet e lashta gjatë epokave t'i devijojnë ujërat për ujitje dhe të parandalojnë vërshimet, duke mundësuar mjetet për të ushqyer dhe mbrojtur popullatën e tyre.

A e pijmë akoma ujin që e pinin dinosaurët?

Uji avullohet nga oqeanet, formon re, bie në formë të shiut (ose borës), dhe kthehet nëpër lumenj dhe oqeane. Vendi ku uji qëndron më së shumti është thellë në oqean dhe thellë në tokë, ku qëndron edhe deri në 10 000 vjet. Mirëpo, uji shkatërrohet edhe në mënyrë kimike gjatë fotosintezës (bimët konvertojnë dioksid karbonin dhe ujin në sheqerëra dhe në oksigjen) por ripërtërihet përsëri gjatë frymëmarrjes (kryesisht proces i kundërt i fotosintezës që krijon energjinë dhe CO2). Ne mund të kalkulojmë sa ujë mbetet nga epoka e dinosaurëve duke kalkuluar sasinë e përgjithshme të ujit në planet dhe sasinë e ujit që shpenzohet në fotosintezë për një vit. Në bazë të kësaj, mund të themi se do të duhej të kalojnë rreth 100 milionë vite për të shkatërruar kimikisht pjesën më të madhe të ujit. Dinosaurët kanë jetuar para 65 milionë viteve. Kështu, një pjesë e ujit që e pijmë është uji i njëjtë por më shumë se gjysma është ujë tjetër.

Mirëpo, shumica nga ne nuk jetojnë në vende të tilla. Ne jetojmë në qytete ku gjithkush dëshiron të bëjë një dush së paku një herë në ditë, të mbajë shtëpitë dhe veturat e pastra, të ujisë bimët ose oborret. Kur kemi kohë të lirë, duam të shkojmë në liqe dhe nëpër plazhe për t'u relaksuar dhe për të bërë not, e jo të notojmë në lëmsh dhe në mbeturina njerëzore.

Prandaj është shumë me rëndësi që uji të respektohet. Me rritjen e numrit të popullatës, fakti që më tepër njerëz jetojnë nëpër qytete, ndryshimi i motit si rezultat i ndryshimit të klimës, rezervat e kufizuara të ujit dhe shpenzimet e trajtimit të ujit para dhe pas përdorimit, cilësia e ujit është temë shumë aktuale. Ndërsa shkencëtarët hetojnë mënyra se si t'i ruajnë ujin nga rubineta dhe si t'i mbajnë oqeanet e pastërta për të përballuar këto sfida, edhe ne mund të bëjmë pjesën tonë të punës për ta kujdesur ujin.

Vazhdo të lexosh për të eksploruar rrugëtimin e ujit dhe përdorimin e tij në jetën tonë të përditshme, mënyrën se si arrin te çesmat tona, si kalon përmes kanalizimit dhe kolektorëve për trajtimin e ujit e deri te lumenjtë dhe detërat, ku mund ta shijojmë edhe një herë.



Rezervoar nëntokësor i ujit të pijshëm

Uji i pijshëm

Uji i rubinetës: vital për shëndetin

Imagjino si do të ishte nëse do të duhej të ecje me orë të tëra deri tek ndonjë burim ose të prisje në një radhë të gjatë njerëzish për të marrë ujin që të duhet ty dhe familjes tënde për të pirë, për t'u larë dhe për të gatuar. Ndoshta do të të dukej sikur merresh me sport, por nuk do të të linte kohë dhe energji për të bërë asgjë tjetër. Ose imagjino si do të ishte nëse do të duhej të vloje ujin para se ta përdorësh. Gjërat që përmendëm janë realitet për rreth 1 miljardë njerëz që nuk kanë qasje në ujë të pijshëm ose instalime hidrosanitare. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, larja me ujë të papastër, pirja e ujit të papastër ose përgatitja e ushqimeve me ujë të papastër janë arsye për 10 % të sëmundjeve në botë. Në rrezik të veçantë janë fëmijët e vegjël.: sëmundjet e diaresë që lidhen me ujin shkaktojnë vdekjen e 1.8 milionë njerëzve çdo vit.

Nëse krahasojmë këto numra me Evropën, mund të themi që ne jemi me fat. Futja në përdorim e instalimeve hidrosanitare – heqja e sigurt e mbeturinave njerëzore dhe ujit të përdorur, dhe ofrimi i ujit të pijshëm nëpër shtëpi – kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit publik, uljen e numrit të sëmundjeve që lidhen me ujin dhe rritjen e jetëgjatësisë.

Thesar i fshehur

Për tre të katërtën e evropianëve, uji i rubinetës vjen nga toka – është ujë i ruajtur nën tokë, mes dheut dhe gurëve, duke përfshirë këtu edhe sipërfaqet e mëdha të mbuluara me ujë, të njohura si ujëmbajtës. Uji i tokës është gjithashtu burim për një pjesë të madhe të ujit që del në sipërfaqe, dhe rrjedh nëpër burime dhe toka të lagështa. Këto burime sigurojnë mbi 50% të ujit të lumenjve gjatë vitit.

Por ky thesar i fshehur është në rrezik. Në shumë shtete, uji përdoret më shpejtë se sa burimet e tij. Kjo gjë shkakton probleme për të ardhmen, por është problem edhe sot: gjysma e tokave të lagështa të Evropës, që kanë rolin e mbrojtësve nga vërshimet dhe pastrimin e ujit, janë në rrezik për shkak të eksploatimit të tepërt të ujit të tokës. Gjithashtu, rritja e kërkesës nga zhvillimi i shpejtë i turizmit, në disa rajone ka shkaktuar thatësira dhe ndërhyrje të ujit të kripur: dukuria kur uji i detit rrjedh në brigje të ujërave të ëmbla. Afër gjysma e popullsisë së Evropës jetojnë në shtete që quhen 'shtete që vuajnë nga stresi i ujit', kurse mungesa e ujit prek 33 pellgje të lumenjve të BE-së[1].

Tokë e fortë ose tokë që thith?


Përdorimi i tepërt i ujit është vetëm një pjesë e problemit. Pjesa tjetër është rreziku i cilësisë së ujit të tokës që vjen nga burimet e ndotjes njerëzore, siç janë bujqësia, industria, kanalizimet që rrjedhin ose gropat septike. Të vetëdijshëm për këtë problem si kurrë më parë, ne sot mbrojmë cilësinë e ujit të tokës më shumë se në të kaluarën. Megjithatë, të gjithë ne, mund të bëjmë akoma më shumë për ta ndaluar ndotjen para se ajo të ndodhë. Toka nën këmbët tona mund të duket e fortë kur ecim mbi të, por ajo thith si sfungjer gjithçka që ne hedhim, qofshin ato metale të rënda që gjenden tek bateritë e harxhuara apo substanca të tjera jo të këndshme që gjenden tek plastikat e ndryshme, plehrat dhe produktet e pastrimit. Këto substanca që i hedhim, sjellin ndotjen e ujit nga i cili ne jemi të varur. Duhet të kalojnë dekada të tëra që ndotja të kalojë tek ujëmbajtësit nëntokësor, sepse uji lëviz shumë ngadalë drejt sipërfaqes nëntokësore të Tokës.

Ndotës të zakonshëm të ujit

Ndotës patogjenë: bakterje që shkaktojnë sëmundje, viruse dhe mikrobe të tjera që gjenden tek kanalizimet e papastra ose në mbeturina të kafshëve nëpër ferma

Kemikalje: organike – detergjentë, yndyrëra, dhjamëra, tretës, herbicide, produkte të naftës, kemikalje që përdoren për produkte të higjienës personale dhe produkte kozmetike; dhe inorganike: shkarkimet industriale dhe nënproduktet, plehrat që përmbajnë nitrate dhe fosfate, metale të rënda dhe baltë.

Gjëra të mëdha: mbeturina dhe mbetje të dukshme në ujë





Kulla e ujit ruan ujin e pastër dhe të pijshëm

Çfarë cilësie ka uji në vendin ku jetoni?

Agjencia Evropiane për Mjedisin Jetësor publikon harta interaktive të cilësisë së ujit në çdo shtet të BE-së. Ato tregojnë rezultate të testeve të ujërave të tokës, lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetarë, përmbajnë detaje për çdo shtet, si dhe pika testimi të niveleve të ndotësve të zakonshëm, siç janë nitritet, nitratet dhe amoniaku.
Shih: http://www.eea.europa.eu/themes/water/interactive

Si prodhohet uji i rubinetës suaj?

Zakonisht uji i rubinetës është ujë pa shije, pa ngjyrë dhe pa erë. E keni menduar ndonjëherë se si vjen deri në këtë gjendje? Mund të duket e thjeshtë, por në fakt duhet shumë punë që uji të arrijë të jetë kaq i mirë. Prapa kuintave është një sistem kompleks i mbledhjes, akumulimit, përpunimit dhe distribuimit të ujit. (shih ilustrimin A).

Kompanitë që furnizojnë me ujë, kanë për detyrë të sigurohen se uji që pijmë nuk është i dëmshëm. Këto kompani japin informata të azhurnuara rreth cilësisë së ujit. Faturat e ujit dhe faqet e internetit të kompanive të ujit janë ato që zakonisht përçojnë këto informata. Këto kompani pagohen për të mbuluar harxhimet që kanë gjatë shpërndarjes së një produkti të mirë. Edhe uji që shpenzohet pa nevojë, kushton. Po ti mund ta përdorësh ujin me kursim? Ç'ndryshim do të bëje ti, në mënyrën se si e përdor ujin?





Uji në shishe krahas ujit të çesmës

Evropianët blejnë gjithnjë e më tepër ujë në shishe, përkundër kontrollit të rreptë i cili siguron se pjesa më e madhe e ujit të rubinetës është uji i pijshëm. Për dallim nga kjo, uji në shishe është shumë më pak i kontrolluar dhe i testuar dhe nuk ekziston ndonjë provë që uji në shishe është më i shëndetshëm. Disa ujëra natyralë mineral përmbajnë nivele më të larta të mineraleve nga ato që preferohen për grupe të caktuara njerëzish, siç janë foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Ekziston gjithashtu edhe brenga nga rreziqet e kemikaljeve të përdorura në shishet plastike.

Uji në shishe ka ndikim të madh edhe në mjedisin jetësor. Është i nevojshëm një numër i madh i resurseve dhe energjisë për të krijuar dhe për të hedhur paketimet, 80 % nga të cilat janë ambalazha vetëm për një përdorim, të cilat nuk mund të rimbushen[2]. Shishet plastike që nuk mbrijnë në depotë e reciklimit, përfundojnë si mbeturina plastike, të cilat nuk mund të shkatërrohen me gjenerata të tëra. Përfundimisht, është edhe ndikimi i transportit të ujit në shishe nga burimi deri nëpër dyqane dhe shtëpi, përfshirë këtu edhe zhurmën, trafikun, CO2 dhe emetimin e gazërave të tjerë.

Megjithatë, në vitin 2009, mesatarja e evropianëve kanë blerë 105 litra ujë në shishe. Në Evropën e jugut njerëzit blejnë më shumë: italianët pijnë rreth 200 litra në vjet për person, kurse finlandezët pijnë më së paku: 16 litra për person në vjet.

A pin ti dhe familja jote ujë në shishe? Testo dallimin me miqtë, duke organizuar një seancë të shijimit të ujit symbyllazi. A mund ta bësh dallimin?

Pse të mos pini ujë nga rubineta në vend të ujit në shishe? Uji nga rubineta monitorohet dhe është i rregulluar si asnjë ujë tjetër i pijshëm, e madje distribuohet drejtpërdrejt në shtëpitë tuaja.

Në vend se të bleni shishe plastike me ujë kur jeni në lëvizje, më mirë mbani një shishe të fortë për ujë, të cilën do ta mbushni çdo herë nga rubineta.

Shteti	Konsumimi	Humbje mesatare nga rrjedhja leakage
	liter / cap. / day	%
Poloni	102	15
Portugali	107	40
Lituani	116	25
Sllovaki	128	32
Malta	130	15
Bullgari	139	54
Hungari	152	18
Republika Jeke	152	20
Belgjikë (Bruksel & Flamania)	153	6
Belgium (Ëallonia)	153	23
Gjermani	155	9
Hollandë	184	5
Danimarkë	191	7
Romani	194	32
Francë	196	23
Austri	214	11
Luksemburg	221	30
Finlandë	231	17
Greqi	239	35
Angli dhe Uells	241	23
Skoci	241	32
Itali	267	29
Spanjë	283	9
Suedi	302	18
Qipro	310	18
Irlandë	317	27
Gjithsej/Mesatarisht	**202**	**21**

Burimi: ENDWARE dhe EUREAU, Pasqyra e ujit dhe ujërave të zeza në Evropë 2008[4]

Sa ujë përdorim?


Evropianët konsumojnë mesatarisht 100-320 litra ujë në ditë për përdorim shtëpiak, varësisht nga shteti[3]. (Konsumimi shtëpiak i ujit përfaqëson rreth 15% të përdorimit të përgjithshëm të ujit në Evropë, që është më pak se gjysma e vëllimit e përdorur për bujqësi, e cila merr një të tretën e vëllimit të ujit).

Mesatarisht, vetëm 3% e ujit të rubinetës përdoret për pirje. Pjesa dërmuese përdoret për të shtyer ujin e papastër të tualetit, për larje, dhe për ujitje të oborreve. Po ti, sa ujë përdor?

Një dush: 35-75 litra
Një banjë: 80 litra
Një shtyerje e ujit në tualet: 8 litra
Lavatriçja: 65 litra
Pjatalarësja: 25 litra
Një larje e veturës me zorrë: 400-480 litra
Një larje e veturës me kovë (4 kova): 32 litra

Në përgjithësi[5], sot në shtëpitë tona përdorim më pak ujë se që kemi përdorur disa vite më parë. Disa nga arsyet për të cilat ndodh kjo gjë, janë: çmimi i ujit në shumë shtete (duhet të pagojmë atë që harxhojmë), vetëdija më e madhe publike dhe përdorimi i pajisjeve shtëpiake që kursejnë energjinë, siç janë lavatriçet dhe pjatalarëset. Për shembull, konsumimi i ujit është më i madh se mesatarja e Evropës në shtetet ku uji nuk pagohet, ose në shtete të tjera ku rrjeti i ujit ka humbje të shumta (për shkak të rrjedhjeve).

Rregulloret që udhëheqin me sistemin e ujësjellësit nëpër shtëpi, janë të projektuara ashtu që të mund të mbrojnë shëndetin publik dhe të promovojnë përdorimin efikas dhe të arsyeshëm të ujit. Ujit të pijshëm duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë. Atij nuk duhet t'i lejohet kontakti me ujërat e zeza ose me ndotës të tjerë (shih ilustrimin B).



Respekto ujin:çfarë mund të bësh TI

Këshilla për përdorimin e ujit



- Bëj dush në vend që të bësh banjë. Mbushja e vaskës kërkon shumë më shumë ujë se një dush i shkurtër.
- Dushi zgjat më shumë se kënga jote e preferuar? Dushet e shkurtër kursejnë ujin.
- Kur e lëmë rubinetën e hapur uji shkon kot, prandaj mbylle rubinetën kur lan dhëmbët. Çuna, e njëjta vlen edhe për rruajtjen!
- A është tualeti më i mençur se ç'mendon ti? Mekanizmi për sistem të shtyrjes së shpejtë të ujit në tualet harxhon 70% më pak ujë se një shtyrje e zakonshme.
- Tualeti nuk është 'kazan plehrash me ujë': ilaçet e kanë vendin në barnatore kurse letrat higjienike e shkopthat për veshë në kazanin e plehrave!
- Lëndët me kemikalje që i përdor në shtëpi mos i derdh asnjëherë në lavaman ose në tokë. Çoji ato në qendrën ku mblidhen mbeturinat.
- S'e duron dot ujin se është shumë i nxehtë? Të duhet gjithmonë të shtosh ujë të ftohtë? Ule temperaturën, kështu do të kursesh edhe energji elektrike.
- Blij shampo që nuk dëmtojnë mjedisin (ekologjike) dhe përdor produkte shtëpiake 'të gjelbërta' sa herë që kjo të jetë e mundur.
- Mbushe plot lavatriçen dhe pjatalarësen dhe laji të gjitha që ke duke lëshuar ato vetëm një herë (dhe jo dy herë).
- A do qanin teshat e tua nëse i vesh përsëri? Bluzat dhe pantallonat mund t'i veshësh lirisht nga dy herë. Gjithashtu, teshat qëndrojnë më gjatë, nëse i lani më pak.



- Lësho lavatriçen dhe pjatalarësi me rrotullim ekonomik dhe përdor sa më pak detergjent për larje.
- A e do ujin po aq sa e do peshqirin tënd? Përdore peshqirin më shumë se një herë. Mund ta bësh këtë sepse kur fshihesh ti je i/e pastër.
- Shfrytëzo maksimumin nga një ditë me shi: mblidh ujin e shiut për të ujitur bimët ose për të larë veturën. Për këtë mund të përdorësh edhe ujërat gri.
- Zgjidh organiken! Ushqimi organik ka cilësi më të mirë sepse nuk kultivohet me pesticide dhe herbicide.
- Kultivimi i bimëve mund të bëjë planetin të vdesë nga uria: nëse përdorni plehrat shtëpiake për të ushqyer bimët apo lulet tuaja, nuk do të keni më nevojë për fertilizues kimikë.
- Bëju avokat i ujit! Merr pjesë në aktivitete dhe ndihmoi të tjerët duke i mësuar si të mbrojnë ujin.

Për më shumë informata dhe për t'u njohur personalisht me Water Maniac Walter bashkangjitu Generation Awake (**http://www.generationawake.eu/**)
ose vizito faqen tonë të Facebookut në: **http://www.facebook.com/GenerationAwake**
Zgjedhjet e tua sjellin nje botë ndryshimesh

Ujërat e zeza

Ku shkon uji i fëlliqur?

I gjithë ai ujë i fëlliqur që e lëshojmë nëpër banjot, lavabotë, dhe vrimat e shkarkimit – një pjesë e këtij uji edhe nuk është aq i fëlliqur – duhet të shkojë diku, apo jo? Nuk shkon direkt në rrjedhat e ujit, në lumin apo plazhin më të afërt, ose së paku shpresojmë që është ashtu!

Mirësevini në botën e ujërave të zeza, një mbretëri fascinuese por shumë pak e njohur, e cila fillon në kanale dhe vazhdon në fund të qytetit, në atë vend me erë që tërmos: te kolektori i trajtimit të ujërave. Ky aktivitet misterioz operon 24/7, duke realizuar një varg procesesh për të zhdukur pjesët e fëlliqura. Pas pastrimit, uji mund të derdhet në ambient pa ndonjë rrezik të shpërndarjes të sëmundjeve ose rrezikun e mbytjes së bimëve ose kafshëve.



Derdhje e kanalizimit

Nuk janë të gjitha fekalet ndotës

Lumenjtë dhe detërat kanë afinitet natyral për të pastruar një sasi të caktuar të mbeturinave organike – fekalet dhe mbetjet e ushqimeve – pasi që këto shkatërrohen në mënyrë biologjike dhe mund të përpunohen nga bakteriet dhe mikro-organizmat. Problemet fillojnë atëherë kur ka më shumë mbeturina organike se sa që mund të përpunohen, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin publik. Ky është rasti me shoqërinë moderne: shumë nga ne jetojnë në zona me popullatë të dendur dhe me qasje të kufizuar në burimet e ujit. Kjo është arsyeja pse është i nevojshëm trajtimi i ujit.


Kemikaljet e ujërave të zeza

Trajtimi i mbeturinave organike është i drejtëpërdrejtë; duhet vetëm të marrim bakteriet e mira për t'i zbërthyer ato. Megjithatë, një pjesë e madhe e ujërave të zeza përmbajnë kontaminues të zakonshëm për shoqërinë moderne, të cilët derdhen nëpër kanale nga industritë dhe amvisëritë. Gjurmët e barërave, siç janë antibiotikët dhe ibuprofeni në mënyrë të vazhdueshme dalin në mostrat e ujit të pijshëm, gjë që paraqet brengë gjithnjë e më të madhe për ndikimin afatgjatë të tyre në njerëzit dhe kafshët, e të mos përmendim kërcënimin nga 'insektet e forta' të cilat kanë krijuar rezistencë ndaj antibiotikëve.

Ndërkaq, metalet e rënda, nuk shkatërrohen në mënyrë biologjike dhe shtohen në fundërrinat e lumenjve, te bimët, insektet dhe peshqit. Ato mund të bëhen helmuese për kafshët dhe njerëzit. Teorikisht, duhet të parandalojmë që ndotësit industrial të mos arrijnë te kanalizimet dhe në shtëpitë tona, të shfrytëzojmë barërat, preparatet higjienike shtëpiake dhe të oborrit t'i përdorim me përgjegjësi, të kufizojmë sasinë e kemikaljeve që derdhen në kanale dhe në tokë. Alternativisht, trajtimi i quajtur 'fundi i gypit' për të pastruar këto substanca nga ujërat e zeza është shumë më i shtrenjtë dhe jo gjithnjë i suksesshëm.

Trajtimi i ujit në Evropë

Aty ku është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, amvisëritë në Evropë janë të lidhura me sistem për kanalizim dhe me kolektorin për trajtimin e ujërave të zeza (shih ilustrimin C). Në vendet pa sistem komunal të drenazhit dhe trajtimit të ujërave të zeza, ujërat e zeza mblidhen në gropë septike para se të dërgohen në



kolektorin për trajtimin e ujërave të zeza, ose rrjedhin në sistem individual i cili përpunon mbeturinat në vendin e ngjarjes para se të derdhet uji i trajtuar nëpër lumenj ose përmes dheut në ujin e tokës. Ndërmarrje të specializuara mbledhin baltën e mbetur për ta hedhur në vend të sigurtë.

Çfarë ndodh në kolektorin e trajtimit të ujërave të zeza?

Kolektori që trajton ujërat e zeza është departamenti i pastrimit të ujërave të papastër. Një varg procesesh të pastrimit ndajnë mbeturinat e ngurta nga ato të lëngshme, dhe largojnë kontaminuesit e dëmshëm ashtu që ajo që mbetet është mjaftueshëm e pastër për t'u derdhur në natyrë.

Kjo len dy produkte: ujëra të zeza në formë të lëngshme (rrymë e trajtuar) dhe mbeturina të ngurta (baltë e trajtuar), të cilat mund të kthehen në mjedisin jetësor në mënyrë të sigurtë. Në Evropë, rrymat e trajtuara kryesisht derdhen në lumenj dhe në det. Balta e trajtuar mund të derdhet (shpesh me anë të djegjes) ose mund të përdoret sërish, për shembull si fertilizues bujqësor.



Tanket për tretje anaerobe, kolektor për trajtimin e ujërave të zeza "Emschermündung" (Gjermani)

Procesi i pastrimit i përshkruar në detaje

Para-trajtimi: në fazën e parë të hapit preliminar me dy etapa, gjithcka që vjen me anë të kanalizimit (shih ilustrimin D, pamja 1) pompohen dhe shoshiten (2) për të hequr mbeturinat e ngurta, siç janë degët e drunjve, plastika, rags, gurët dhe qelqi i thyer, të cilat përndryshe dëmtojnë ose bllokojnë pompat dhe aparatet e kolektorëve që ndajnë shkumën. Gjërat e shoshitura hidhen nëpër gropa ose digjen. Në fazën e dytë (3), zhavorri dhe rëra lejohen nëpër kanale, para se të lahen dhe të përdoren sërish, për shembull për të ndërtuar rrugë.

Trajtimi primar: sedimentacioni: tanku i sedimentacionit (4) lejon ndarjen e mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta. Balta zë vend, kurse yndyrërat ngrihen në sipërfaqe. Balta largohet për trajtim, kurse yndyrërat ndahen. Mbeturinat e lëngshme dërgohen në trajtim sekondar.

Trajtimi sekondar: biologjik: në këtë fazë (5), mikro-organizmat e ujit – bakteriet dhe protozonet – largojnë substancat organike nga mbeturinat njerëzore, mbeturinat ushqimore, sapunët dhe detergjentet. Krijesat e vogla konsumojnë pjesëzat e mbeturinave, dhe kështu pastrojnë ujin.

Trajtimi terciar: kjo fazë përfundimtare e trajtimit përmirëson cilësinë e rrjedhës edhe më tutje. Mund të përdoren metoda të ndryshme, varësisht nga kontaminuesit që duhen pastruar (për shembull nitrogjeni ose fosfori si ushqyes). Ato poashtu mund të përfshijnë dezinfektim fizik ose kimik (përmes lagunave (6) ose mikrofiltrimit).

Kanali i ujit nga stuhia: gjatë rreshjeve të mëdha, disa nga kanalizimet mund të orientohen në kanale të veçanta ose tanke të ujit të stuhisë (7) për të pritur trajtimin në kohë kur kolektori mund të përballet me vëllim plotësues të punës. Në stuhitë ekstreme, këto kanale mund të vërshojnë duke lëshuar kanalizim jo të trajtuar ose të trajtuar në mënyrë mekanike drejtpërsëdrejti në rrjedhat e ujit.

Derdhja: uji i pastruar derdhet përmes kanalit të drenazhit (8) në një shtrat uji (lum, liqe ose det).

Trajtimi i baltës: balta duhet të trajtohet, në mënyrë që të



Kolektor për trajtimin e ujërave të zeza

largohet substanca organike dhe mikro-organizmat që shkaktojnë sëmundje. Një mënyrë për trajtimin e baltës është tretja anaerobe (10), një sistem i mbyllur ku balta përzihet për të lëshuar biogas (metan dhe oksigjen) (12), i cili pastaj digjet (si gazi natyral) për të ngrohur tretësit në temperaturën e njëjtë që të vazhdojnë me procesin e vet të dekompozimit. Ndonjëherë balta shtresohet dhe forcohet (13) para digjestimit, kurse dehidron (11) pas digjestimit, në mënyrë që të redukojë përmbajtjen e lëngshme sa më shumë që mundet, dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë shpenzimet e hedhjes ose të ripërdorimit.

Kemikaljet mund të shtohen (14) në fillim të trajtimit për të shkaktuar precipitate e fosforit, ose zhytjen e tij në fund – në formë të baltës.
Në fund të procesit, balta e trajtuar mund të përdoret sërish si fertilizues ose si kompost për bimët, pasi që përmban ushqyes vitalë (nitrogjen dhe fosfor), si dhe karbon organik, i cili përmirëson strukturën e tokës.

Në disa vende, balta kontaminohet me metale të rënda ose me ndotës të tjerë, si rezultat i mbeturinave industriale që hyjnë në rrjetin e kanalizimit. Për këtë arsye, shumë vende preferojnë të djegim baltën që të redukojnë rrezikun nga shpërndarja e ndotësve nëpër tokat bujqësore ose nëpër oborre.

Përdorimi i sërishëm i ujit të shiut dhe ujit gri

'Uji gri' është termin për ujin që përdoret në kuzhinë, banjo, dushe dhe në lavatriçe, i cili nuk është i kontaminuar me kanalizim (ujë të zi). Shtëpitë mund të kenë të instaluara sisteme trajtimi që mundësojnë që uji gri sërish të përdoret për të shtyer ujin e tualeteve. Uji i mbledhur i shiut mund të përdoret për të ujitur kopshtet. Uji i shiut gjatë kohë është grumbulluar dhe është përdorur në këtë mënyrë dhe në disa vende, është e zakonshme që shtëpitë të kenë tanke për grumbullimin e ujit të shiut.

Problemi me shiun

Shumë sisteme të vjetra të kanalizimit e kanë vështirë të ballafaqohen me sasinë e shiut e cila e tejkalon sasinë mesatare. Të stërngarkuara nga vëllimi i madh i ujit kanalet vërshohen dhe dalin nga shtrati, duke shkaktuar rrjedhjen e ujërave të zeza të papërpunuara nëpër rrugë dhe nëpër shtëpi.

Ky problem është tani urgjent në shumë zona. Nga njëra anë, ka gjasa që ndryshimet klimatike mund të shkaktojnë ngjarje edhe më të paparashikueshme të motit. Nga ana tjetër, qytetet moderne kanë proporcion të lartë të sipërfaqeve të 'vulosura': trotoaret, rrugët dhe ndërtesat, të cilat nuk lejojnë që uji i shiut të filtrohet në bar dhe në tokë dhe kështu shtojnë ngarkesën e kanaleve.

Për të trajtuar ujin e stuhive tani po disejnohen sisteme më të reja. Këto sisteme riorientojnë ujin drejt kanaleve posaçërisht të ndërtuara ose drejt rrjedhave të ujit që mund të ballafaqohen me vëllime të mëdha ose të tepërta të ujit të shiut. Ilustrimi D paraqet kolektor tipik të trajtimit.

Mbyllja e qarkut: reciklimi i ujit

Për vendet e thata me sasi shumë të vogël të rreshjeve ose në zonat dendësisht të populluara, është e logjikshme që ujërat e zeza të reciklohen menjëherë pas trajtimit e jo të derdhen nëpër lumenj dhe në det. Në shumë raste, uji i recikluar nuk përdoret për të pirë por për shembull për ujitjen e parqeve apo për të shtyrë ujin e tualeteve.

Përballja me sfidat e të ardhmes – mungesa e ujit dhe ndryshimi i klimës, ka nevojë për hulumtime që kanë të bëjnë me mbylljen e qarkut – reciklimin e ujit, si për shembull si të përmirësohet testimi dhe pastrami. Sistemet aktuale nuk kanë mundësi të largojnë në mënyrë efektive mikrobe, kemikalje dhe mbeturina të caktuara farmaceutike, gjë që është esenciale nëse duam që uji të përdoret sërish për pirje.

Ndalesa e ardhshme: lumenjtë dhe deti

Evropa ka arritur progres të rëndësishëm në trajtimin e ujërave të zeza në 20 vjetët e fundit, mirëpo akoma ka mundësi për përmirësim. Pikë së pari, duhet të kujdesemi më shumë për të larguar produktet e dëmshme nga ujërat e zeza; duhet të zhvillojmë metoda më të avancuara të trajtimit dhe të mbajmë koston sa më të ulët.

Në fund, pas rrjedhjes nëpër lumenj dhe rrjedha të ujit, ujërat e zeza orientohen drejt detit, ku kontaminuesit që nuk janë larguar gjatë procesit të trajtimit do ta shtojnë ndotjen ekzistuese në mjedisin ujor. Këtu përfshihen pesticide dhe fertilizues që janë pastruar nga toka, si dhe produkte të hedhjeve dhe mbeturinave industriale, sidomos plastike. Pasiqë shumë nga këto substanca nuk mund të shkatërrohen me vite të tëra (për shembull, një shishe plastike nuk tretet disa qindra vjet), ato përfaqësojnë kërcënim real për mirëqenien afatgjate të oqeanve tona, dhe përfundimisht rrezik për burimin e gjithë ujit tonë. Edhepse ne marrim ujin nga burimet e ujit të freskët, ky ujë më në fund kthehet në oqean për të vazhduar ciklin e ujit i cili mban jetë. Pjesa më e madhe e furnizimit të ujit në planetin Tokë (97.2 %) gjindet nëpër oqeane, dhe megjithëse shkripëzimi i ujit të oqeaneve është i mundur, kjo kushton shumë dhe kërkon sasi të mëdha të energjisë.


Çfarë ndodh me trajtimin e ujërave të zeza në vendin ku jetoni?

Hartat interaktive të Agjencisë Evropiane për Mjedisin Jetësor përfshijnë të dhëna mbi trajtimin e ujërave të zeza në mbarë Evropën. Zbuloni nivelin e trajtimit në vendin dhe qytetin tuaj në: **http://www.eea.europa.eu/highlights/themes/water/interactive/soe-wfd/uwwtd**

Pirja e urinës së recikluar në univers

Astronautët e Stacionit Ndërkombëtar të Universit mund të pijnë urinë të recikluar, falë sistemit jashtëzakonisht të avancuar teknologjik për trajtimin e ujit të instaluar në anijen kosmike në vitin 2009. Kjo mundëson që anija kosmike të jetë e vetëmjaftueshme për një kohë më të gjatë dhe zvogëlon sasinë e anijeve të rifurnizimit.

D



Kolektor për trajtimin e ujërave të zeza Duisburg-Kaslerfeld (Gjermani)

1. Kanali hyrës
2. Godina e shoshitjes
3. Kurthet e rërës
4. Tanku i sedimentacionit
5. Trajtim biologjik
6. Lagunat e sedimentacionit
7. Tanket e ujit të stuhisë
8. Kanali i drenazhit
9. Qendra operative
10. Tanket e tretjes të baltës
11. Godina e dehidrimit të baltës
12. Tanket e gazit
13. Shtresuesi i baltës
14. Fundërrinat e fosfatit

Drejt plazhit!

Larja në det, në liqene dhe lumenj është një nga argëtimet më të popullarizuara. Çdo vjet, miliona evropianë shkojnë nëpër plazhe për t'u larë dhe relaksuar me miq dhe familjarë. Mirëpo, si mund të pajtohemi me imazhet e broshurave për pushime me plazhe të pastërta dhe me familje të buzëqeshura që luajnë në det, kur jemi të vetëdijshëm për ndotjen e ujit? Industria, bujqësia, peshkataria, turizmi dhe aktivitetet e lira (siç është shëtitja me varkë), dhe zonat shumë të populluara bregdetare, nxjerrin mbeturina në det – gjë që mund të paraqesë rrezik serioz për mjedisin detar dhe për notuesit. Larja në ujë të papastër mund të shkaktojë dhimbje dhe çrregullime barku, infektime të kanaleve të frymëmarrjes dhe të dëmtojë lëkurën.



Njerëzit nuk duan duqa cigareje në plazh!

Mbeturinat janë problem gjithnjë e më i madh. Duqet e cigareve, najlonet plastike dhe kapakët e shisheve i gjejmë nëpër plazhe gjithnjë. Disa njerëz e trajtojnë banjën si korpë llomesh ku hedhin shkopinj për pastrimin e veshëve, duqe të cigareve, letra sanitare, letra të lagëta, madje edhe pelena. Kjo jo vetëm që rrezikon bllokimin e gypave, por gjithashtu ndot ambientin jetësor, pasiqë këto gjëra në fund mund të dalin edhe nëpër plazhe. Hedhja e mbeturinave në tualet është pothuajse njëlloj si hedhja e mbeturinave në rrugë.

Natyrisht, kolektorët për trajtimin e ujërave të zeza duhet të kenë mundësi të identifikojnë ndotësit më të mëdhenj dhe mbeturinat (edhepse kjo mund të bëhet edhe pa i bllokuar filterët e tyre). Megjithatë, disa lundrojnë direkt nëpër përrenj dhe lumenj kur kanalet e stuhisë vërshojnë, duke anashkaluar plotësisht kolektorin e trajtimit të ujërave të zeza.

Përveç letrës higjienike, mbani mend këtë udhëzim: mos hidhni gjëra në tualet.

Ujërat e larjes po pastrohen

Nuk janë të gjitha lajmet e këqia. Nëse don të zhytesh në det, mbuahu me frymë: ujërat e notimit nëpër Evropë janë gjithnjë e më të pastër që nga viti 1970, kur filloi kontrolli dhe testimi i cilësisë. Përmirësime të mëdha u vërejtën pas vitit 1990, kryesisht, falë trajtimit më të mirë të ujërave të zeza. Para kësaj periudhe, sasi të mëdha të ujërave të patrajtuara ose pjesërisht të trajtuara të kanalizimit, në mënyrë rutinore hidheshin në ujërat e Evropës.

Duhanxhi, vini re: plazhi nuk është taketuke e madhe

Duqet e cigareve janë mbeturinat më të shpeshta – mbi se 4.5 miliardë të tilla hidhen si mbeturina çdo vjet në mbarë botën – dhe duhet të kalojë një periudhë 25 vjet që të dekompozohen. Krahas faktit se bëhen nga një lloj plastike, filterët përmbajnë mbetje toksike nga të gjitha kemikaljet që mund t'i gjejmë te cigarja – përshirë këtu arsenin, plumbin, benzinën dhe formaldehid. Këto kemikalje hyjnë në rrjedhat e ujit dhe në det, ku shpezët dhe gjitarët e detit i hanë, duke i marrë gabimisht për ushqim. Nëse pini cigare, mbani me vete taketuke xhepi dhe hidhni duqet në korpën e plehrave ose në shtëpi.



Vendet e BE-së kanë marrë edhe hapa të tjerë nga viti 2006, për të përmirësuar cilësinë e ujit të larjes, në mënyrë që të mbrojë shëndetin dhe ambientin jetësor. Rregullat vlejnë për të gjitha ujërat ku larja është e autorizuar ose shfrytëzohet nga një numër i madh i njerëzve, duke përfshirë këtu liqenet, lumenjtë, plazhet, rezervoarët dhe pellgjet.. Mirëpo, këto rregulla nuk vlejnë për qëllime të tjera rekreacioni, siç është surfimi ose lundrimi, ose nëpër pishina.

Në vitin 2011, 21 000 vende larjeje u testuan në mbarë BE-në, dy të tretat e të cilave ishin ujëra bregdetarë, kurse të tjerat ishin lumenj dhe liqene. Shumica nga ato kanë cilësi të mirë: më se 9 nga 10 vende të testuara, plotësojnë standardet minimale të cilësisë të caktuara me direktivë. Përqindja e ujërave për larje që nuk i përmbushnin standardet, ishte vetëm 1.8 %; kurse vetëm 1% ishin ujëra që u ndaluan ose që u mbyllën (208 vende).



Vetëm nese nuk mund ta shohish, nuk do të thotë se nuk është aty

Çfarë testohet?

Numri më i madh i vendeve duhet të testohen së paku katër herë gjatë një sezoni të larjes, duke filluar nga nisja e sezonit. Mostrat e ujit testohen për të definuar nivelin e dy bakterieve: E-koli dhe enterokoki i barkut. Të dyja bakteriet ndodhen në barkun e njerëzve dhe të kafshëve, dhe e përbëjnë florën normale të shëndetshme të zorrëve. Mirëpo, prezenca e tyre në ujë tregon se uji është i ndotur nga kanalizimi ose mbeturinat e gjedhëve.

Notimi në ujë të ndotur është rrezik shëndetësor, sidomos kur njerëzit gëlltisin substancat fekale. Nuk janë të gjitha llojet e bakteries E-koli të dëmshme, mirëpo disa mund të shkaktojnë dhimbje serioze të barkut. Në raste të rralla, kontaminimi me E-koli mund të shkaktojë sëmundje vdekje-prurëse. Prandaj është jashtëzakonisht me rëndësi që ujërat e zeza të trajtohen (shih ilustrimin E) dhe të shmanget notimi në zonat e ndotura me mbeturina. Prandaj edhe i lajmë duart pasi që të kemi përdorur banjon dhe para se të përgatisim ushqimin.

Ujërat për notim duhet gjithashtu të testohen edhe për rrezikun nga burime të tjera të ndotjes që mund të ndikojnë në shëndetin e notuesve, siç janë allgat me ngjyr blu dhe të gjelbër (cianobakterie), të cilat mund të jenë të dëmshme nëse gëlltiten dhe mund të shkaktojnë skuqjen e lëkurës, ose allgat makro dhe fitoplanktonët detarë. Këto të gjitha testohen për shenja të dukshme të ndotjes dhe mbeturinave.

Gjeni vendin më të përshtatshëm për të notuar

Platforma Kujdeseni Tokën6 mundëson të dhëna lajv mbi cilësinë e ujit të larjes, me anë të karakteristikës WaterWatch. Harta e saj interaktive tregon cilësinë e ujit të larjes në 28 vende në Evropë. Zmadhoni për të parë dhe për të komentuar cilësinë e ujit afër vendit tuaj.

European Environment Agency

Hartat interaktive japing informata më të detajuara lidhur me zonat indivuale të larjes:
http://www.eea.europa.eu/themes/water/wise-viewer



Flamuri i Kaltër u krijua në Francë, në vitin 1985. Sot: 41 vende marrin pjesë në këtë program. Në vitin 2010, 3 450 plazhe fituan statusin e Flamurit të Kaltër. Shih: http://www.blueflag.org/

Plazhet me Flamuj të Kaltër

Flamuri i Kaltër është etiketë e njohur që ndahet nga OJQ-ja Fondacioni për Edukim mbi Ambientin Jetësor, për pastrimin e plazheve dhe ujit detar. Për t'u kualifikuar, plazhet duhet të plotësojnë standarde strikte të cilësisë dhe pastërtisë së ujit. Këto plazhe duhet të kenë edhe kushte adekuate të tualeteve, të kenë rregulla mbi kampimin dhe kontrollin e qenve, qasje të sigurtë, pajisje për emergjenca, si dhe informim për ambientin jetësor dhe edukim për përdoruesit.

Mbeturinat detare

Çdo vjet, miliona tonë mbeturinash përfundojnë në oqean – dhe mbeten atje. Plastika, druri, metali, qelqi, goma, pëlhura dhe letra prodhohen kryesisht nga aktivitetet njerëzore dhe përbëjnë llojin e vetëm të mbeturinave të cilin natyra nuk mund ta tresë (shih ilustrimin F). Vjen nga toka, transportohet nga era ose lumenjtë, nga gropat e menaxhuara keq, kanalet e stuhive dhe nga mbeturinat e rrugës (për shembull paketimet e ushqimit të shpejtë ose kanaçet e pijeve). Mirëpo, vjen gjithashtu edhe nga deti: mbeturina të hedhura nga anijet dhe aktivitetet e njerëzve që kanë ndikim në mjedisin ujor, siç janë minat detare dhe peshkimi (për shembull pajisjet e hedhura të peshkimit).



Rrjetet e hedhura të peshkimit mund të vrasin breshkat

Mbeturinat detare shkaktojnë rrezik për shëndetin: mbeturinat mjekësore ose ato të kanalizimit kontaminojnë ujin, ndërsa gjërat e mprehta ose të thyera mund t'u shkaktojnë lëndime atyre që shkojnë në plazh. Kjo ka një ndikim ekonomik: pastrimi i plazheve dhe porteve është i kushtueshëm, e anijet dhe pajisjet e peshkimit mund të dëmtohen. Dhe mund t'i kërcënohet jetës së ujit: fokat, balenat dhe breshkat detare janë gjetur të gulfatura nga fjongot e tullumbaceve, unaza plastike, dhe rrjete të hedhura të peshkimit, të cilat kanë shkaktuar mbytjen e tyre. Gjitarët detarë, zogjtë dhe peshqit gjithashtu i marrin mbeturinat e plastikës për ushqim, dhe kështu marrin lëndime të mbrendshme ose bllokojnë sistemet e tretjes. Plastika në veçanti, është kërcënim pasi që nuk tretet biologjikisht, por ndahet në shumë grimca të vogla, dhe në fund bëhet 'pluhur plastik' mikroskopik. Në disa produkte (siç janë kremërat e pastrimit) shtohet mikroplastika. Ato kalojnë sistemin e kanalizimit dhe përfundojnë në mjedisin e ujit. Veç kësaj, baza e naftës në fragmentet e vogla tërheq kemikaljet e tjera që lundrojnë në oqean, siç janë ndotësit e vazhdueshëm organikë (POP) dhe PCB. Këto koncentrohen në fragmente, në nivele që janë miliona herë më të larta se nivelet e ambientit në ujë detar, duke kthyer fragmentet plastike në hape të vogla helmuese. Kemikaljet e absorbuara nga plastika mund të hyjnë lehtë në zinxhirin ushqimor dhe mund të përfundojnë edhe në tryezën tuaj.

Në disa nga oqeanet e botës, rrymat qarkore kanë shkaktuar ishuj të tërë lundrues me mbeturina. Më i njohuri, Ngastra e Madhe e Mbeturinave të Paqësorit Verior, është i gjërë qindra kilometra dhe përbëhet nga gjëra të mëdha dhe koncentrim të lartë të grimcave të vogla plastike. Janë bërë disa studime lidhur me ndikimin e kësaj 'supe plastike', dhe gjithnjë e më brengosëse janë efektet potenciale helmuese në zinxhirin ushqimor nga kemikaljet e shfrytëzuara për prodhimin e plastikës, të cilat dëmtojnë qeniet njerëzore, me anë të kontaminimit të oqeanit. Në një studim të fundit të një lloji të zogut, Fulmari Verior në Atlantikun e Veriut, u gjet sasi e madhe e plastikës në barkun e pothuajse të gjithë zogjve të ngordhur që ishin mbledhur për këtë studim.

Ndihmoni reduktimin e mbeturinave detare duke ripërdorur qesen tuaj plastike; mos hidhni mbeturina në rrugë, nëpër tualete dhe në rrjedha të ujit; dhe merrni pjesë në ditët e pastrimit të plazheve: http://www.signuptocleanup.org. Ne gjithnjë mund të përmirësojmë menaxhimin e mbeturinave në tokë, në mënyrë që të parandalojmë mbeturinat të arrijnë në oqean, mirëpo, në përgjithësi, duhet të bëhemi më të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve tona.



Nëse do të gëlltitnit mbeturina sa zogjtë e detit, relativisht do të kishin madhësinë e hamburgerit!



Çfarë bën BE-ja



Shenjat e zonave të mbrojtes së ujit në Evropë

Pasiqë uji rrjedh lirshëm përtej kufijve, vendet e BE-së janë pajtuar të menaxhojnë burimet e ujit në mënyrë kolektive me përdorimin e pishinave të lumenjve, pa marrë parasysh kufijtë nacionalë. Këto vende kanë identifikuar 110 rrethe të pellgjeve lumore7 duke përfshirë degët e tyre, estuaret dhe ujërat nëntokësorë. Vendet punojnë së bashku dhe ndajnë përgjegjësitë e pishinës së lumit, duke u pajtuar për një plan menaxhimi me vendet e tjera që e ndajnë atë. Pastaj, çdo vend duhet të implementojë planin në suaza të territorit të vet. Qëllimi i përcaktuar në Direktivën e BE-së për Kornizën e Ujit, është të përmirësojnë kushtet e të gjitha ujërave të BE-së deri në vitin 2015 (me shtyerje të afatit në raste të veçanta).

Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm

Uji i çesmës është rregulluar me ligj në BE që nga viti 1998. Direktiva e Ujit të Pijshëm përcakton standardet minimale të cilësisë, të cilat obligojnë Shtetet Anëtare të garantojnë furnizimin e ujit të sigurtë dhe të pastër nëpër amvisëri.

Standardet shqyrtohen çdo pesë vjet, për të marrë parasysh njohuritë aktuale dhe ndryshimet e mundshme në udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çdo furnizimi të ujit për më shumë se 50 persona duhet t'i testohen rregullisht 48 karakteristika, duke filluar nga ngjyra, aroma dhe shija e deri te prania e metaleve siç janë alumini, kadmiumi, hekuri dhe plumbi, kemikaljet dhe bakteriet potencialisht të dëmshme. Sasia më e madhe e ujit të pijshëm në Evropë i plotëson këto standarde, edhepse ka mundësi për progres në cilësinë e ujit të pijshëm të furnizuar për komunitetet e vogla (deri në 5 000 persona).

Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza

Për t'iu shmangur dëmtimit të shëndetit tonë dhe ambientit jetësor me anë të eksponimit në ujërat e zeza të patrajtuara – kanalizimi dhe uji i përdorur nga amvisëritë, dhe ujërat e zeza nga industria – **Direktiva Urbane e Ujërave të Zeza**, e hartuar në vitin 1991, ndërmerr hapa të zvogëlojë ndotësit e hedhur në ambientin jetësor.

Autoritet lokale duhet ta grumbullojnë dhe ta trajtojnë ujin nga fshatrat dhe qytetet me 2 000 ose më tepër banorë. Kolektorët e trajtimit të ujërave të zeza duhet të plotësojnë standardet minimale. Standarde më strikte vlejnë aty ku uji mund të dëmtojë mjedise më të ndjeshme ose shëndetin e njeriut. Shumica e vendeve të BE-së tani vënë shumicën e sistemeve të ujërave të zeza në funksion, për të plotësuar rregullat e kësaj Direktive; kurse Shtetet më të reja Anëtare kanë afat ta bëjnë këtë deri në vitin 2018. Shtetet që nuk i respektojnë këto rregulla mund të gjobiten.

Ruajtja e pastërtisë në ujërat e larjes

Komisioni Evropian, çdo vjet boton detaje lidhur me cilësinë e ujit të larjes në Evropë. Në vitin 2011, raporti i ujit të larjes tregoi rezultate nga 21 000 vende, në bazë të informacioneve të siguruara nga Shtetet Anëtare, në suaza të **Direktivës** së BE-së **për Ujin e Larjes**. Qeveritë nacionale janë gjithashtu të obliguara të informojnë publikun lidhur me cilësinë e ujit të larjes – në kohë për sezonin e larjes, sidomos në zonat ku larja nuk është e këshilluar ose madje edhe është e ndaluar.



Cilësia e shkëlqyeshme e ujit të larjes

★★★ shkëlqyeshëm
★★ mirë
★ mjaftueshëm
– dobët

Pastrimi i detërave dhe oqeaneve

Çështja e mbeturinave ujore shqyrtohet në **Direktivën Kornizë** BE-së 2008 **për Strategjinë Ujore**. Shtetet Anëtare duhet të garantojnë se detërat e tyre arrijnë 'statusin e mirë të mjedisit' deri në 2020, me hartimin e një strategjie të mbikqyrjes dhe për arritjen e qëllimeve.

Rregullorja e BE-së ndihmon në garantimin e ujit të pastër për larje



Referenca

[1] Broshurë: "Uji është për jetë: Si ndihmon Direktiva Kornizë e Ujit për mbrojtjen e burimeve të Evropës" (nëntor 2010), faqe 8 http://ec.europa.eu/environment/water/pdf/WFD_brochure_en.pdf

[2] Ueb faqe e Federatës Evropiane të ujërave në shishe http://www.efbw.eu/sustainability.php?classement=03

[3] Konsumimi i amvisërive dhe ambienti jetësor', Raporti i Agjencisë Evropiane të Ambientit Jetësor 11/2005, faqe 32: http://www.eea.europa.eu/publications/eea_report_2005_11

[4] Raporti final "Financimi i investimeve të nevojshme për t'u harmonizuar me DWD dhe për të rehabilituar rrjetet e distribuimit të ujit në BE" Komisioni Evropian, Drejtoria-Gjenerala e Ambientit Jetësor ENV.G.1/FRA/2006/0073, shtator 2011

[5] Raporti "Financimi i investimeve të nevojshme për t'u harmonizuar me DWD dhe për të rehabilituar rrjetet e distribuimit të ujit në BE"

[6] Ueb faqja Eye on Earth: www.eyeonearth.eu

[7] http://ec.europa.eu/environment/water/participation/index_en.htm

Literaturë

- Drejtoria Gjenerale e Komisionit Evropian për Mjedisin Jetësor – çfarë bën BE-ja për mbrojtjen e cilësisë së ujit: http://ec.europa.eu/environment/water/index_en.htm
- Drejtoria Gjenerale e Komisionit Evropian për Ambientin Jetësor – Oqeanet, Detërat dhe Bregdetet tona: http://ec.europa.eu/environment/marine/index_en.htm
- Fletushka për Mbeturinat Detare (2010) dhe fletushka për Mbeturinat Detare në Mesdhe (shkurt 2012): http://ec.europa.eu/environment/marine/publications/index_en.htm
- Mungesa e Ujit & Thatësirat, fletushkë (shtator 2010) http://ec.europa.eu/environment/water/quantity/pdf/brochure.pdf
- Agjencia Evropiane e Mjedisit – raporte dhe statistika mbi gjendjen e ujit në Evropë: http://www.eea.europa.eu/themes/water
- WISE – Sistemi Informativ për Ujin në Evropë: http://water.europa.eu/
- Organizata Botërore e Shëndetit – uji, shëndeti dhe higjiena publike në nivel global: http://www.who.int/topics/water/en/
- Fletushka e ujërave të zeza urbane (2010): http://ec.europa.eu/environment/water/water-urbanwaste/info/index_en.htm

Fotografitë

f. 4, 8, 9, 14, 27 - © Shutterstock
f. 17 - © iStockphoto
f. 5 - © iStockphoto, Thinkstock
f. 16 - © Daniel Ullrich
f. 19 - © Fotoarchiv Ruhrverband
f. 20 - © Marine Conservation Society/eyeforanimage
f. 22 - © Ferdi Rizkiyanto
f. 23 - © Christof Mainz
f. 24 - © National Oceanic and Atmospheric Administration (NOAA), © JA van Franeker IMARES
f. 26 - © Waterbedrijf Groningen, © Dr. Eugen Lehle

Ilustrimet

Nga Rrjeti i Shërbimit Evropian (ESN), © Bashkimi Evropian

Komisioni Evropian

A do t'i pije ujërat e zeza? — Një broshurë uji për të rinjtë

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian

2012 – 28 pp. – 21 x 21 cm

ISBN 978-92-9238-081-6
doi:10.2871/34931

Porosia e një kopjeje pa pagesë deri sa nuk harxhohen kopjet:

Për një kopje të vetme:
nga Libraria e BE-së – qasja onlajn te botimet e Bashkimit Evropian:
http:// bookshop.europa.eu

Për disa kopje:
Me anë të qendrës më të afërt informative nacionale Europe Direct:
http://europa.eu/europedirect/meet_us/index_en.htm

MK-32-12-301-SQ-C



Publications Office

ISBN 978-92-9238-081-6

